

Cilësitë e bashkëshortes së mirë

Allahu thotë:

فَالصَّالِحَاتُ قَانِتَاتٌ حَافِظَاتٌ لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ - " **Gra të mira janë ato që janë të bindura (ndaj Allahut dhe burrave të tyre), që ruajnë fshehtësitë (kur burrat nuk janë prezent), aq sa Allahu ua mundëson t'i ruajnë.** Nisa 34.

Cilësia e parë:

Me fjalën قَانِتَاتٌ – kaaniteetun është për qëllim: se janë vazhdimisht në adhurim ndaj Allahut. Kunuut në gjuhën arabe d.m.th.: kur dikush është i vazhdueshëm dhe këmbëngulës në adhurimin ndaj Allahut, i kushton rëndësi e kujdes dhe nuk i ndahet adhurimit e përlules ndaj Tij, i ruan obligimet e fesë së Tij. Të gjitha këto përfshihen te fjala "kaanitet". Këtu hyn ruajtja e kujdesi për obligimet e Islamit. Në këtë kuptim kanë ardhur hadithe të shumta, prej tyre: "*Kur gruaja fal pesë kohët e namazit, agjëron muajin e Ramazanit, ruan nderin e saj dhe i bindet burrit të saj, ajo hyn prej cilës derë të xhenetit që dëshiron.*" Ibn Hibani. Dhe: "*Kur gruaja fal pesë kohët e namazit, e agjëron muajin e Ramazanit, ruan nderin e saj dhe i bindet burrit të saj, do t'i thuhet në Ditën e Gjykimit: "Hyr nga cila derë e xhenetit që dëshiron."* Imam Ahmedi. Allahu ia premton përmes gjuhës së të Dërguarit të Tij këtë shpërblim dhe mirësi të madhe.

Baza e themeli i përmirësimit të gruas është kur së pari e përmirëson raportin me Zotin e saj, duke u përpjekur që në mënyrën më të mirë e të bukur ta adhurojë Allahun e t'i afrohet Atij duke qenë e vazhdueshme në adhurim ndaj Tij. Myslimania duhet të dijë se ky përmirësim duke u munduar të jetë besimtare e mirë dhe e devotshme, sipas këtij përshtkrimi në hadithe, është sekreti i lumturisë dhe shpëtimit të saj, është sekreti e pasjes sukses në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Sukses në jetën e kësaj bote përfshin edhe: jetën bashkëshortore, pasjen fëmijë besimtarë të dëgjueshëm e të mirë dhe një jetë të bekuar, të bereqetshme.

Ky ajet përmend dy aspekte:

Aspekti i parë që ka të bëjë me Zotin e saj: të jetë kaanitet në raport me Zotin e saj, të mos jetë neglizhente, por të jetë e vazhdueshme.

Aspekti i dytë që ka të bëjë burrin e saj: **حَفِظْتُ لِلْغَيْبِ** - që ruajnë fshehtësitë (kur burrat nuk janë prezent), **aq sa Allahu ua mundëson t'i ruajnë**". Qëllimi me “ **حَفِظْتُ لِلْغَيْبِ** - që ruajnë fshehtësitë (kur burrat nuk janë prezent)” është: i ruajnë së pari të drejtat e burrave të tyre, e kjo kuptohet automatikisht se i ruajnë të drejtat e tyre edhe kur ata janë prezent, pra i ruajnë bashkëshortët sa i përket pasurisë së tyre: (nuk i dëmtojnë), shtratit (nuk i tradhtojnë) dhe të gjitha obligimeve në raport me ta.

Allahu na tregon se gruaja arrin ta bëjë këtë nëse Ai i jep sukses, “ **بِمَا حَفِظَ اللَّهُ** - **aq sa ua mundëson Allahu t'i ruajnë**”. Këtu na tregon Allahu se kur gruaja arrin

të jetë e tillë, me këto attribute, kjo është prej ndihmës së Tij ndaj saj. Ajo nuk e arrin këtë sukses për shkak të aftësisë, zgjuarsisë apo mendjemprehtësisë së saj. Porse, kjo është sukses prej Allahut, jo meritë e saj. Allahu e ka ndihmuar, ia ka lehtësuar këtë gjë dhe ia ka mundësuar ta realizojë.

Cilësia e dytë: Ruajtja nga shejtani

Misioni i shejtanit është që njerëzve t'ua çrregullojë jetën, t'ua prishë fenë, apo moralin, apo raportet mes njerëzve, e sidomos raportet mes bashkëshortëve, të prishë dashurinë mes vëllezërve etj. Qëllimi i shejtanit është të bëjë shkatërrime e çrregullime në tokë. Siç ka ardhur në hadith, ai çdo ditë dërgon ushtritë e tij për të realizuar misionin e tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"Iblisi e vendos fronin e tij mbi ujë, pastaj dërgon njësitë e tij ushtarake (për të bërë shkatërrime në tokë). Ai që (prej tyre) arrin pozitën më të afërt tek Iblisi është ai i cili bën shkatërrimet më të mëdha në tokë (mes njerëzve). Njëri prej tyre vjen tek ai dhe i thotë: "Kam vepruar këtë e këtë", e ai ia kthen: "S'ke vepruar gjë." Vjen një tjetër i thotë: "Nuk i jam ndarë filanit (me vesvese, cytje, fitne) derisa e kam ndarë nga gruaja e tij." Atëherë Iblisi e afron atë dhe thotë: "Ti je ushtari i duhur (që kryen punë)." Muslimi.* Bashkëshortët duhet të jenë të vëmendshëm në këtë çështje dhe ta kuptojnë mirë se e kanë një armik të fshehur i cili i sheh e ata nuk e shohin atë. Shejtani vazhdimisht u bën vesvese, cytje, kurthe e intriga, derisa të mbjellë armiqësi, ngatërresa e

mospajtime mes tyre. Pra, prej cilësive të gruas së mirë është se ajo gjithmonë ruhet dhe i kushton vëmendje mos rënies në kurthet e shejtanit, mospranimit të veseve, joshjeve e cytjeve të tij, nuk lejon që shejtani të hedhë vesvese në zemrën e saj, e nëse e dëgjon dhe i bindet shejtanit pastaj pasojat janë të mëdha, do të prishen raportet mes dy bashkëshortëve e kështu shkatërrohet familja. Siç e dimë, shumë prej familjeve dhe martesave janë shkatërruar kur anëtarët e familjes i janë bindur apo i kanë dëgjuar cytjet e shejtanit. Sikur secili të kërkojë mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar e të mos i pranojë cytjet e tij, nuk do të ndodhnin përçarje e ndasi. Anëtarët e shtëpisë muslimane kanë nevojë ta mbrojnë veten e tyre me të gjitha shkaqet e ruajtjes prej shejtanit dhe shkaqet e largimit të tij prej shtëpisë (të cilat kanë ardhur në sunet).

Cilësia e tretë: Përpjekja që ta gëzojë burrin e saj

Gruaja duhet që vazhdimisht të mundohet e të kujdeset që ta gëzojë burrin e saj, të fusë gëzim, hare e lumturi në zemrën e tij, sidomos atëherë kur ai e shikon. Sa herë që e shikon, ai duhet të shohë një pamje tek ajo (fytyrë, trup e rroba) e cila e gëzon dhe fut lumturi në zemrën e tij. Ajo ka për detyrë dhe obligim të përpiqet në realizimin e kësaj gjëje. E po ashtu duhet vazhdimisht ta trajtojë veten duke e bërë shprehi e zakon bindjen e përgjigjen ndaj urdhrave të burrit, pa treguar kundërshtim, mendjemadhësi, kryelartësi etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

"(Gruaja më e mirë) Është ajo të cilën kur burri e shikon, ai gëzohet, i bindet burrit të saj kur ai e urdhëron dhe nuk e kundërshton atë as në veten e saj e as në pasurinë e saj me gjërat që ai nuk i pëlqen apo nuk i do." Gruaja duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe kësaj çështjeje (pamjes, rrobave, stolisjes, pastërtisë, largimit të aromës së keqe, heqjes së qimeve nga vendet e turpshme); gruaja të mundohet që ai të shohë një dukje tek ajo e cila e gëzon atë. Po ashtu, sa i përket urdhrave, dëshirave e nevojave të tij, duhet të jetë realizimi i tyre synim i gruas. Shumë prej grave nuk njohin zbukurim veçse atëherë kur dalin nga shtëpitë e tyre, për raste e takime të ndryshme me gratë muslimane (ne jemi duke folur për gruan muslimane e cila kur del jashtë nuk zbukurohet para meshkujve të huaj). E ndërsa në shtëpi me burrat e tyre qëndrojnë me një pamje jo të mirë; e gjen burri me aromë të padëshiruar, me flokë të shprishura, me veshje të vjetërsuar etj. Këto gjëra nuk duhet të jenë te bashkëshortja e mirë muslimane ngase e pengojnë burrin e saj prej saj duke mos dëshiruar t'i afrohet asaj. Sahabijet kanë rregulluar edhe shtëpitë e tyre kur burrat u janë kthyer nga udhëtimi (që t'i gjejnë në formën më të mirë e më të bukur).

Cilësia e katërt: Të mos gjejë qetësi duke qenë burri i saj i hidhëruar me të

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"A doni t'ju tregoj për gratë tuaja në xhenet?** Çdo grua e dashur dhe që lind shumë; kur ajo zemërohet, apo

burri saj sillet keq ndaj saj, apo ai zemërohet me të, ajo i thotë: "Kjo është dora ime, mbi dorën tënde (e vendosë mbi dorën e tij), nuk do të vë gjumë në syrin tim (nuk do të qetësohem e rehatohem) tërë natën derisa ti të jesh i kënaqur me mua", derisa të më falësh (kur ajo e ka fajin) apo derisa të qetësohesh e të të largohet hidhërimi e zemërimi. Fatkeqësisht sot ka gra të cilat nuk i kushtojnë rëndësi kësaj gjëje, nuk e kanë problem pse flenë një natë, dy netë, një javë e ndoshta dhe një muaj, duke qenë burrat e tyre të hidhëruar me to.

*Para se Pejgambëri salAllahu alejhi ue selem të përmendë cilësitë e tyre, do të tregojë se ajo bashkëshorte që ka këto cilësi të virtytshme (e ka kaluar tërë jetën me to) do të jetë prej atyre që e meritojnë hyrjen në xhenet.

Cilësia e pestë: Të jetë e dashur

Pejgambëri salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“Gratë më të mira tuajat janë ato që janë të dashura (الْوَدُود)...”* Bejkehiu. Vërtetë ky është një tipar i lavdëruar, të cilin duhet ta ketë bashkëshortja e mirë. Pra, të jetë e dashur, ta dojë burrin e saj dhe sa më shumë të përpiqet që ta fitojë zemrën dashurinë e tij, duke folur fjalë të mira, të bukura, të ëmbla, duke u sjellë mirë e me moral, e po ashtu me dukjen e saj etj.

Cilësia e gjashtë: Që lind shumë

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Gratë më të mira tuajat janë ato që janë të dashura, që lindin shumë (الأولاد)...”*** Kjo është një cilësi e mirë e i lavdëruar te gruaja, porse nëse ka ndonjë problem shëndetësor apo sëmundje, nuk llogaritet si e mangët apo që është përpjekur për stopimin e lindjeve. Allahu nuk e merr në llogari nëse ajo ka ndonjë arsye sheriatike të ligjshme, dhe kjo nuk e bën që të përjashtohet prej grave të mira. E nëse gruaja është prej atyre që lind, e megjithatë mundohet të ndërpresë lindjen e fëmijëve (shtatzënitë) me gjëra të ndryshme, apo nuk i vazhdon, atëherë në këtë rast kjo e dëmton në besimin e fenë e saj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Martoni ato gra që janë të dashura dhe që lindin shumë, sepse unë do të krenohem me numrin e shumtë tuaj në Ditën e Gjykimit.”*** Gruaja duhet të mundohet që sa më shumë të sjellë në jetë fëmijë dhe të marrë shkaqet e kësaj, e pastaj t’i edukojë ata në frymën islame.

Cilësia e shtatë: Të jetë e bindur

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Gratë më të mira tuajat janë ato që janë të dashura, që lindin shumë, që janë të bindura...”*** **المؤاتية** - el muweetijeh” ka kuptim më të gjerë (ndonëse e përkthyer “të bindura”). Domethënia: është ajo grua e cila nuk është as e ashpër e as e vrazhdë, nuk është e ashpër në fjalët e saj e as në zemrën e saj, është grua që

u bindet, i dëgjon dhe u përgjigjet urdhrave të bashkëshortit, nuk tregon mendjemadhësi e kryelartësi, nuk e kundërshton burrin e saj, nuk largohet prej tij, nuk ka zemër të ngurtë, por zemra e saj është plotë mëshirë e dashuri ndaj burrit të saj.

Cilësia e tetë: *Të jetë ngushëlluese*

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Gratë më të mira tuajat janë ato që janë të dashura, që lindin shumë, që janë të bindura, që janë ngushëlluese (المَوَاسِيَة).”*** Është ajo e cila e ngushëllon burrin e saj, gjithmonë i gjendet pranë, sa herë që ai ka ndonjë problem apo shqetësim mundohet ta ngushëllojë, e ndihmon në punë të mira që të jetë adhurues më i madh i Allahut e që të arrijë lumturinë e shpëtimit në të dy botët. Të gjitha këto cilësi që u përmenden (cilësia e pestë, e gjashtë, e shtatë dhe e tetë) Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i kushtëzon me fjalën vijuese ***“إِذَا اتَّقَيْنَ اللَّهَ – nëse ato kanë frikë Allahun”***. Pra, këto cilësi i bëjnë dobi gruas nëse ajo ka frikë Allahun. Nëse të gjitha këtyre cilësive u përmbahet për ndonjë interes a dobi të kësaj bote, atëherë ajo nuk llogaritet se e ka frikë Allahun dhe nuk përfiton shumë prej këtyre cilësive. Por, nëse stoliset me to dhe i zbaton që të arrijë Kënaqësinë, shpërblimin dhe dashurinë e Allahut, duke e pasur frikë Atë, atëherë ato i bëjnë dobi në të dy botët.

Cilësia e nëntë: *Të mësojë e të marrë dije*

Cilësi tjetër e bashkëshortes së mirë muslimane është pajisja sa më shumë me dije rreth sunetit e haditheve, e sidomos haditheve që përmendin cilësitë e nënçmuara te gratë, në mënyrë që të largohet prej tyre (atyre cilësive). Njeriu kur e mëson të keqen, duhet ta mësojë që të mos bie në të e të largohet prej saj; d.m.th. të keqen për të cilën ka paralajmëruar Kurani e suneti. Një nga të parët tanë në fe ka shkruar: “*E mësova të keqen jo për ta vepruar, por për t’iu larguar. Kush nuk e njeh të keqen, bie në të.*”

Cilësia e dhjetë: *Të jetë nën shërbim të burrit të saj*

Cilësi tjetër e bashkëshortes së mirë është përmbushja e të drejtave të burrit të saj, të mos tregohet neglizhente në këtë dhe të japë maksimumin në shërbimin ndaj tij. Do të ndalemë të meditojmë rreth hadithit që transmetohet te Nesaiu. Një ditë Esmë ka shkruar te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem për ta pyetur për një gjë të caktuar e ai i është përgjigjur, pas kësaj e ka pyetur: “***A ke bashkëshort?***” – “Po.” – “***Si je në raport me të?***” Atëherë ajo i është përgjigjur: “*Nuk tregohem neglizhente dhe e mangët në të drejtat që ka ai ndaj meje përveçse në atë që nuk kam mundësi (aftësi) ta veproj.*” – “***Shiko (mirë) se si është gjendja jote në raport me të, ngase ai është xheneti ose zjarri për ty!***” Kur bashkëshorti bëhet xhenet ose zjarr për gruan e tij? Gruaja duhet të ndalet e ta kuptojë mirë këtë realitet që e ka thënë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe t’ia kujtojë vazhdimisht vetes këtë pyetje: “Si je në raport

me të?” Ta çojë ndërmend këtë pyetje, sikur me të Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem po i drejtohet asaj. Kjo është një çështje shumë madhore për të cilën ka tërhequr vërejtjen ai salAllahu alejhi ue selem. Pra, gruaja ka obligime e detyra ndaj burrit, të cilat duhet t'i përmbushë. Kur ajo i kryen në mënyrë të plotë, atëherë burri i saj do të jetë xheneti i saj. E nëse është e mangët e neglizhente duke mos i çuar në vend ato, ai do të jetë zjarri i saj, pra shkak i kësaj ajo do ta marrë dënimin e Allahut.

Cilësia e njëmbëdhjetë: *Të mos shpenzojë tepër*

Gruaja nuk duhet ta lodhë e mundojë burrin e saj sa i përket shpenzimit. Ajo nuk duhet ta shpenzojë në mënyrë të tepërt pasurinë e burrit të saj duke e shpërdoruar (bërë masraf). Allahu kur përmend cilësitë e besimtarëve të mirë thotë: **“...dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes...”** Furkan 67. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem një ditë ka mbajtur një ligjëratë dhe aty ka përmendur disa çështje të kësaj bote dhe botës tjetër, pastaj ka sjellë një ngjarje të ndodhur te beni izrailët: **“*Fillimi i shkatërrimit të beni izrailëve ka filluar atëherë kur gratë e të varfërve kanë filluar të kërkojnë shpenzime prej burrave të tyre ashtu siç kanë shpenzuar pasanikët për gratë e tyre* (veshje, stoli, zbukurime etj).”**

Cilësia e dymbëdhjetë: *Të mos i mohojë mirësitë e burrit ndaj saj*

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: “*Nuk e ka falënderuar Allahun ai që nuk i falënderon njerëzit.*” Në një hadith tjetër tregohet se ai salAllahu alejhi ue selem u ka thënë disa grave: “*Keni kujdes të mos i mohoni të mirat e bamirësve!*” E kanë pyetur se si ndodh kjo e ai ka thënë: “*Ka mundësi që ndonjëri prej jush t’i shtyhet martesë, për shkak të prindërve të saj, pastaj ia mundëson Allahu të martohet me një burrë dhe e furnizon edhe me fëmijë, pastaj ajo zemërohet dhe i mohon të mirat e tij e i thotë: “S’kam pasur kurrfarë të mire prej teje kurrë!”* Buhariu. Po ashtu në një hadith ka thënë: “*Allahu nuk e shikon një grua e cila nuk është mirënjohëse (falënderuese) ndaj burrit të saj përderisa ajo është nevojtare për të.*” Nesaiu.

Cilësia e trembëdhjetë: *Ta respektojë burrin e saj*

Cilësi tjetër është respektimi ndaj burrit dhe njohja e së drejtës dhe pozitës që ia ka dhënë Allahu atij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “*Nuk lejohet që askush t’i bëjë sexhde dikujt tjetër. Sikur të urdhëroja dikë t’i bie në sexhde dikujt, atëherë do të urdhëroja gruan që t’i bie në sexhde burrit të saj.*” Tebaraniu.

Cilësia e katërbëdhjetë: *Të mbajë drejtësi mes fëmijëve*

Cilësi tjetër është që nëse Allahu e begaton një grua me fëmijë, atëherë duhet të mbajë drejtësi mes fëmijëve të saj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“*Tregohuni të drejtë në raport me fëmijët tuaj!*”** Këtë e ka përmendur tri herë. Dijetarët kanë thënë që duhet treguar të drejtë qoftë dhe në puthje, nëse e puth njërin dy herë, duhet edhe tjetrin njëjtë. E të mos flasim në gjëra të tjera. Gjithmonë duhet përmbajtur drejtësisë ndaj fëmijëve.

Cilësia e pesëmbëdhjetë: *Qëndrimi në shtëpi*

Cilësi tjetër e gruas së mirë është se duhet të qëndrojë në shtëpinë e saj. Nuk duhet të jetë prej atyre që vazhdimisht del e hyn. Nëse del për ndonjë nevojë e domosdoshmëri, atëherë nuk duhet të dalë e stolitur, e pafumosur etj. Po ashtu kur del, duhet ta ulë shikimin dhe ta ruajë nderin e saj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“*Gruaja është avret. Kur del prej shtëpisë së saj, shejtani e bën objektiv të tij. Dhe ajo në asnjë gjendje (vend) nuk është më afër Zotit të saj sesa kur qëndron në shtëpinë e saj.*”** Tebaraniu. Kur qëndron në shtëpi, është në adhurim të plotë dhe më afër Allahut. E kur del, shejtani përmes saj mundohet të fusë joshje e fitne në mesin e njerëzve që të shkatërrohet shoqëria.

Cilësia e gjashtëmbëdhjetë: Të mos përhapë sekretet e burrit

Gruas nuk i lejohet të përhapë sekretet e fshehtësitë e burrit të saj, gjërat që janë të veçanta mes saj dhe burrit të saj, edhe atëherë kur mes tyre nuk ka harmoni apo kur martesë vjen deri te ndarja. Duhet ta ketë frikë Allahun në këtë aspekt. E njëjta gjë vlen edhe për burrin. Një ditë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem u thotë disa prej burrave dhe grave: ***“Ndoshta ndodh që në mesin tuaj ka prej burrave që tregojnë se çfarë ka vepruar me gruan e tij dhe ka ndonjë grua që tregojnë se çfarë ka vepruar me burrin e saj.”*** Kjo gjë më së shumti ndodh në mesin e grave, kur janë me shoqet, me koleget etj. Nuk u kushtojnë kujdes kësaj gjëje, e shohin si të lehtë. Dhe pastaj u ka thënë: ***“Mos veproni kështu (ndalohej). Kush vepron kështu, është njëjtë si shembulli i shejtanit i cili bën marrëdhënie intime me një shejtane në rrugë në mesin e njerëzve dhe ata shikojnë.”*** Ahmedi.

Cilësitë e këqija të grave

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Gratë më të këqija janë الْمُتَبَرِّجَاتُ (el muteberrixhaat)...”*** Këto janë ato gra të cilat dalin të stolisura e të zbukuruara (jashtë normave islame) prej shtëpive, me rroba të bukura, të stolisura e të parfumosura, të pambuluara etj. Kjo grua bëhet objektiv (cak) i shejtanit, siç ka ardhur kjo në hadith. Përmes saj shejtani përpiket ta prishë

shoqërinë islame. Kur ajo del në këtë formë prej shtëpisë së saj, bëhet “ushtar” i shejtanit, i cili përmes saj mundohet të prishë nderin, moralin e fenë e njerëzve. Ai përmes saj nxit dhe fut fitne e joshje duke përhapur gjërat e pamoralshme e imoralitetin ndër njerëz.

Pastaj vazhdon të thotë: “ الْمُتَخَيَّلَات (el mutekhajilet)...” Këto janë ato gra që janë kryelarta, mendjemëdha. Këtu shohim se si Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem zbukurimin, mosmbulimin e stolisjen e gruas kur del jashtë shtëpisë, e ka ndërlidhur me mendjemadhësinë e kryelartësinë. Pa dyshim mes këtyre dy cilësive ka ndërlidhje të ngushtë. Kështu, kur ajo del në atë formë që thamë, a ka mundësi që të jetë e thjeshtë, e nënshtruar dhe e përlulur para Allahut? Kurrsesi, nuk ka mundësi që të ketë pastaj cilësitë e nënshtrimit e thjeshtësisë. Por, do të dalë kryelartë e mendjemadhe, duke menduar se është më e ngritur sesa të tjerat, do të ketë vetëpëlqim për dukjen etj. Një grua e tillë i bën dëm vetes me këtë, jetës së saj, e jetës bashkëshortore. E ajo e cila mundohet të jetë e thjeshtë, ka zemër të mbushur me turp.

Dersi “Cilësitë e bashkëshortes së mirë”